



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E MBROJTJES

10-16 SHKURT JAVA E MBROJTJES





MINISTERIALI I NATO-S

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s në **Bruksel**, ku kryefjala e diskutimeve ishte rritja e **kontributit** për paqen mes Rusisë dhe **Ukrainës**. Gjatë takimeve të ministrit Vengu me **homologët** nga SHBA, Franca, Italia, Kroacia dhe Hungaria, u theksua forcimi i **bashkëpunimit** ushtarak dhe avancimi i projekteve të përbashkëta në industrinë e **mbrojtjes**.

★★★★★

PJESË E MEKANIZMIT TË MBROJTJES AJRORE

Shqipëria tashmë është pjesë e një mekanizmi evropian të rëndësishëm të sigurisë në fushën e mbrojtjes. Gjatë Ministerialit të NATO-s në Bruksel, së bashku me Portugalinë, u nënshkrua memorandumi për zhvillimin e Iniciativës Evropiane për Mbrojtjen Ajrore (ESSI), e cila tani përfshin 23 shtete.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES


INVESTIMI NË BAZËN E KUÇOVËS

Qeveria Shqiptare mbetet e vendosur të modernizojë Bazën Ajrore të Kuçovës në një nivel të ri operacional dhe strategjik. Brenda pak javësh do të përfundojë edhe ndërtimi i infrastrukturës së mirëmbajtjes së dronëve.

JM



mod.gov.al





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

DY ANIJE I SHTOHEN POLICISË KUFITARE

Dy anije të klasit “Vedeta 2000”, donacion i Guardia di Finanza dhe misionit Interforza, i shtohen shërbimeve të **Kufirit Detar**. I pranishëm në ceremoninë e **dhurimit**, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e cilësoi këtë një moment të rëndësishëm në **forcimin** e kapaciteteve të **monitorimit** të hapësirave detare të Shqipërisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

KOMANDANTI I RI I POLICISË USHTARAKE

Nënkolonel **Dhimitër Selmanaj** është tashmë komandanti i ri i **Policisë Ushtarake**. I pranishëm në ceremoninë e prezantimit të tij, që përkon edhe me **33-vjetorin** e Policisë Ushtarake, ishte edhe ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, i cili vlerësoi rolin e Policisë Ushtarake dhe angazhimin e saj me **agjencitë** e tjera ligjzbatuese.



mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES

OPERACIONI I EOD

Ekipi EOD i batalionit të xhenios asgjësoi një granatë dore të Luftës së Dytë Botërore, e **gjetur** pranë tubacionit të ujit të pijshëm në fshatin Karjan, Gjirokastër. **Operacioni** u krye me kujdes, pa ndërprerë **furnizimin** me ujë të qytetit të Gjirokastrës.



mod.gov.al

JM



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MBROJTJES

KONFERENCA E MYNIHUT

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, si pjesë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Sigurisë së **Mynihut**, theksoi rëndësinë e **ndërlidhjes** së infrastrukturave kritike në Europën Juglindore për sigurinë dhe **qëndrueshmërinë** e rajonit. Gjatë **diskutimeve** me Institutin për Bashkëpunim dhe Zhvillim, u bë thirrje që BE dhe NATO të mbështesin **financiarisht** projektet infrastrukturore të Korridorit VIII.

